



BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I RRUGES “VIDHISHTE-DRIZE”,

Vidhishte

RELACION TEKNIK

Miratohet,
Kryetari i Bashkisë
Majlinda Buçi



Vendi : Fshati Vidhishte, Bashkia Roskovec

Përshkrim i përgjithshëm, Bashkia Roskovec

Pas miratimit të ndarjes se re administrative-territoriale ne vitin 2015 , Roskoveci mbajti statusin e “Bashkisë” si një nga 61 bashkitë e vendit tonë. Pozitiv është fakti se kjo bashki rifitoi territoret e saj duke përfshirë edhe fshatrat e ish-komunave Strum , Kuman e Kurjan. Qendra e Bashkisë është në Roskovec dhe ka në përbërje edhe 3 Njësi Administrative : Kuman, Kurjan dhe Strum.

Aktualisht përfshihen 14 fshatra, me një popullsi prej rreth 32 163 banorë, sipas rregjistrat të Gjendjes Civile.

Vidhishte është një fshat i pozicionuar në Jug-perendim të qytetit te Roskovecit, i cili njihet për terrenin fushor. Popullsia në këtë fshat kryesisht e siguron jetesën me prodhime bujqësore, blegtorale, agrumet dhe sera. Përmes ketij projekti synohet të realizohen koncepte të reja dhe sa më origjinale, për të ndryshuar imazhin e këtij vendi, i cili duhet të shërbejë në dobi të zonës.

Është e rëndësishme te kuptohet që koncepti eshte bazuar në kerkesat e zones, i pergjigjet nevojave te komunitetit, por njëkohësisht është informuar nga eksperiencia të sukseshme te vendeve te tjera.

Eshte kryer një diskutim i gjërë me publikun dhe aktorë të tjerë për të pasur një program sa më të gjërë gjatë projektimit dhe per te kuptuar se si ndikon rehabilitimi i nje hapesire urbane ne teresi.

Përfituesit

Projekti për rikonstruksionin e kesaj rruge do i japë mundësi këtij komuniteti, të kenë akses më të lehtë, një mjeshtës më të pastër, një vizualitet më të mirë. Ky projekt do të rigjenerojë një zonë të rëndësishme per banoret, dhe do ta kthejë këtë fshat në një vend me te frekuentueshem. Duke funksionuar si një zonë te asfaltuar, te shtruar me trotuare dhe te gjelberuar, ky vend do të ketë aksesibilitet per mjete të ndryshme dhe per kembesoret. Përfitimet sociale dhe shendetesore janë të konsiderueshme.



dëmtim i punimeve të maskuara të infrastrukturës ekzistuese. Për më hollësishët kontraktori duhet të zbatoj Rregulloren e Sigurimit Teknik për punën në ndërtim , dhën nga ISTN-ja Shtator 2000.

Zgjidhja teknike paraqet :

- 1- Përgatitjen e terrenit për ndërtimin e objektit, pastrimin e terrenit , gjërrmimin e terrenit për themele, dheu do të ripërdoret për mbushjen e themeleve dhe ngritjen e nivelit të tokës përreth objektit.
- 2- Punime prishjeje
- 3- Punime rikonstrukzioni
- 4- Punime rrugore
- 5- Punime trotuari dhe lulishte
- 6- Kanalizimi i ujërave të bardha
- 7- Punimet elektrike

Afati i kryerjes së punimeve

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin “Rikonstruksion i rruges Vidhishte-Drize, fshati Vidhishte” nevojitet nje afat prej 6 muajsh. Menyra e kryerjes se punimeve jepet ne grafikun e punimeve bashkelidhur raportit teknik.

Preventivi i punimeve

Preventivi është hartuar në bazë të VKM 629 datë 10.07.2015, dhe vlera e plote është
16'920'776 Lekë me TVSH.

Hartoi : Ing. Erion Hoxha

